



NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e mërkurë, në datën 13 maj 2020, përmes mjeteve të komunikimit elektronik në distancë, u zhvillua mbledhja e radhës së Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Gentian	SALA	Kryetar
Sami	NEZAJ	Zëvendëskryetar
Agron	GJEKMARKAJ	Anëtar
Gledis	GJIPALI	Anëtar
Suela	MUSTA	Anëtar

AMA, pasi shqyrtoi çështjet e rendit të ditës, vendosi:

1. “Mosrinovimin e autorizimit të shoqërisë “Beqaj Kabllor 2014” sh.p.k., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Beqaj”. (**Vendimi nr. 39, datë 13.05.2020**)
2. “Miratimin e një ndryshimi në vendimin nr. 183, datë 19.12.2019, “Për miratimin e projektbuxhetin për vitin 2020”, të ndryshuar, për vijimin e fushatës së informimit të publikut për procesin e digjitalizimit në qarqet Elbasan, Shkodër, Lezhë dhe Vlorë”. (**Vendimi nr. 40, datë 13.05.2020**)

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 13 maj 2020